




Pranimar / Dorezuar Primijsen / Profato Received / Delivery	31. 12. 0	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHCK	3367/2020		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.363/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.363/2020 të datës 18.11.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Kolovica e Vjetër” pa numër në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 14-117/01-195384/20 të datës 26.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 30.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.363/2020 të datës 18.11.2020 e parashtruar nga ankuesit
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr. 14-117/01-195384/20 i datës 26.10.2020 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prishtinës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimit të tij, duke sistemuar ankuesin në pozitën “Menaxher i Tatimit në Pronë”, sipas Akt Emërimit të datës 15.02.2013 sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1216/19 të datës 09.10.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit me numër AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 09.10.2010 me Aktgjykim me numër A.nr.1216/19 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit Milaim Krasniqit ndërsa ka anuluar Vendimin me numër A/02/543/2016 të datës 10.05.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Vendimin e Komisionit të Ankesave me numër Nr.007-148390 të datës 06.08.2015, duke e detyruar Komunën e Prishtinës që paditësin ta kthej në



vendin e punës me të gjitha të drejtët dhe detyrimet e përcaktuara në vendin e punës sipas Akt Emërimit të tij..., ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin me numër AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 e ka refuzuar ankesën e Komunës së Prishtinës duke e vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1216/19 të datës 09.10.2010 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi pas marrjes së Aktgjykimin me numër AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 Gjykata e Apelit e Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative me të cilin e ka refuzuar ankesën e Komunës së Prishtinës duke e vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1216/19 të datës 09.10.2010 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datën 29.09.2020 ka parashtruar kërkesë për zbatimin e aktgjykimit të plotfuqishëm gjegjësisht kthimin në vendin e punës me të gjitha të drejtët dhe detyrimet e përcaktuara në vendin e punës me numër protokollin 117-01-017 6909/20 tek Kryetari i Komunës së Prishtinës.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, më datë 26.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-117/01-195384/20 me të cilin ankuesin e ka sistemuar në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit" me arsyetimin që pozita e mëparshme e është zënë në përputhje me procedurat ligjore, pra kthimi në pozitë ekuivalentet me gradë dhe koeficient të njëjtë me pozitën të cilën i lartpërmenduri e ka ushtruar më herët.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 14-117/01-195384/20 të datës 26.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, më datë 18.11.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollin 2633/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës më datë 03.12.2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 52633/2020 të datës 18.11.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1216/19 të datës 09.10.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi me Nr. 14-117/01-195384/20 të datës 26.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt Emërimit e datës 15.02.2013; Kërkesën për zbatimin e Aktgjykimit të plotfuqishme-kthim në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në vendin e punës e datës 29.09.2020; Akt Emërimit e datës 13.11.2020 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 03.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Ankuesit me Vendimin e datës 18.06.2015 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës i është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension. Pas shfrytëzimit të drejtës së ankimit nga ankuesi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A/02/415/2015 të datës 26.10.2015 respektivisht Vendimin A/02/543/2016 të datës 10.05.2017 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke vërtetuar vendimet e Komunës së Prishtinës. Meqenëse Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative sipas Aktgjykimit A.nr.1216/19 të datës 09.10.2019 ka detyruar Komuna e Prishtinës që Milaim Krasniqin ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtët dhe detyrimet e përcaktuara në vendin e punës sipas Akt Emërimit të tij..., atëherë në pajtim me këtë aktgjykim i cili është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin me numër

AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 i cili e ka refuzuar ankesën e Komunës së Prishtinës duke e vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1216/19 të datës 09.10.2010 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Komuna e Prishtinës është e obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 15.02.2013 në pozitën “Menaxher i Tatimit në Pronë”.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht neni 53 ka përcaktuar se *“Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës”*, rrjedhimisht nuk janë plotësuar asnjë nga këto kushte për rastin e ankuesit, dhe po ashtu nuk ka asnjë dëshmi që pozita që ankuesi ka mbajtur është shuar apo ristrukturuar siç përcaktohet me nenin 54 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj mbi këtë bazë Vendimi me numër Nr. 14-117/01-195384/20 i datës 26.10.2020 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.363/2020

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

